



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 08.06.2016

Ref.: 409/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 42-të, të mbajtur më 31 maj 2016, mori:

## V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr.257/16, e datës 12.05.2016 e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, si e pa bazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.236/16, datë 22.04.2016.

## Arsyetimi

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) më datë 12.05.2016 ka pranuar kërkesë nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) nr.236/16, datë 22.04.2016. Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës përmes kërkesës për rishqyrtim të vendimit të parashtruar më 12.05.2016 ka kërkuar që të ndryshohet vendimi dhe që kohëzgjatja e akreditimit të jetë për tri vite.

KSHC ka shqyrtuar kërkesën e Fakultetit Juridik dhe ka vendosur të refuzojë kërkesën për rishqyrtim të datës 12.05.2016 dhe të lë në fuqi vendimin e KSHC-së të marrë më datë 22.04.2016.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) ka analizuar të gjeturat në raportin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit për Fakultetin Juridik në mbledhjen e mbajtur më 12.04.2016. Raporti i Vlerësimit të Ekspertëve Ndërkombëtarë të Akreditimit përmban një numër të madh të vërejtjeve dhe problemeve të cilat në kohën e vizitës së ekspertëve ndërkombëtarë janë identifikuar. Raporti ndër të tjera vë në pah këto çështje:

- Cilësia e dobët e Raportit të Vetvlerësimit dhe mungesa e informatave
- Përmbajtja identike e përshkrimit të programeve të ndryshme në vlerësim
- Dyfishim i plan programeve (kurrikulave) në mes programeve të studimit në nivele të ndryshme të studimit

- Disproporcion i lartë në mes të numrit të studentëve të regjistruar për programet e studimit në raport me numrin e stafit akademik
- Mos përmbushja e kërkesave bazike për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit për sa i përket hapësirave të Fakultetit Juridik

KSHC ka konsideruar se raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimi ka mos përputhje në mes përmbajtjes së raportit dhe rekomandimit final për akreditimin e programeve të studimit të Fakultetit Juridik. Meqenëse Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) nuk bën akreditimin më kusht të programeve të studimit, KSHC mori vendim të mos marr në konsiderim raportin e vlerësimit të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Prandaj, KSHC mori vendim që të zgjasë për (1) një vit periudhën e akreditimit për të gjitha programet që ishin në proces të riakreditimit.

Në kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-sënr.236/16, datë 22.04.2016, Fakulteti Juridik ka paraqitur të dhëna të reja të cilat në kohën e vlerësimit nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit nuk janë prezantuar nga Fakulteti.

Me qëllim të vërtetimit të dëshmive dhe të dhënave të reja të ofruara nga Fakulteti Juridik, KSHC vendosi që këto të dhëna të vërtetohen nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit dhe Fakulteti të dorëzoj aplikacion të ri për riakreditim.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës, Fakulteti Juridik
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.

---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë